

Nr. Prot. 006/B/18

VENDIMI Nr. 1112

Për

Shqiptimin e Sanksionit Ekonomik për operatorin IPKO Telecommunications LLC

Në mbështetje të nenit 10, paragrafi 7), nenit 17.2.8), nenit 79, paragrafi 1) dhe 2), nenit 101 paragrafi 2) dhe nenit 103 paragrafi 1) të Ligjit Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike (*tutje referuar; Ligji ose LKE*), në bazë të Aktgjykimit A.nr. 943/2010 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, i vëretuar me Aktgjykimin AA.nr. 72/2016, me të cilin është kërkuar që çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendoje, si dhe nenit 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje - ARKEP ose Autoriteti*), për shkak të mos zbatimit të Vendimit nr. 15 për Përgjigjimet Ligjore (nr. prot. 32/1/10), Bordi i ARKEP i përbërë nga:

- 1) z. Kreshnik Gashi, Kryetar
- 2) z. Nijazi Ademaj, Anëtar
- 3) z. Hazir Hajdari, Anëtar
- 4) z. Bahri Anadolli, Anëtar
- 5) z. Shqiprim Pula, Anëtar

në mbledhjen e 25-të, të mbajtur më datë: 16 Janar 2018, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës unanimisht vendosi si më poshtë:

V E N D I M

- I. Operatorit “IPKO Telecommunications” LLC i shqiptohet sanksioni ekonomik në shumë prej njëqind e pesëdhjetë e dymijë e pesëqind euro (152,500.00 €) për shkak të mos zbatimit të vendimit nr. 15 për Përgjigjimet Ligjore (*nr. prot. 32/1/10*).
- II. Meqenëse, IPKO Telecommunication LLC me dt. 06/10/2010 ka ekzekutuar sanksionin ekonomik në shumë prej njëqind e pesëdhjetë e dymijë e pesëqind euro (152,500.00 €), atëherë shqiptimi i sanksioni ekonomik vetëm konfirmohet nga ARKEP dhe konsiderohet i ekzekutuar.
- III. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit .

ARSYETIMI

ARKEP (ish ART) me Vendimin nr. 30 (dt. 07/09/2010; nr. prot. 67/1/10) ka shqiptuar sanksionin ekonomik për operatorin IPKO Telecommunications LLC për shkak të mos zbatimit të vendimit nr. 29 dhe dispozitave të akteve tjera normative të aplikueshme.

Operatori IPKO Telecommunications LLC, me dt. 06/10/2010 ka ekzekutuar sanksionin ekonomik në shumë prej njëqind e pesëdhjetë e dymijë e pesëqind euro (152,500.00 €), por nuk ka zbatuar vendimin nr. 15 të datës 12 prill 2010 dhe ka parashtruar padi pranë gjykatës kompetente për anulimin e vendimit nr. 30.

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative me aktgjykimin A.nr. 943/2010 të datës 19/01/2016 ka aprovuar kërkesëpadinë e IPKO's dhe e ka anuluar vendimin nr. 30 të ARKEP dhe çështjen e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje të ARKEP.

ARKEP brenda afatit ligjor ka ushtruar ankesë, mirëpo Gjykata e Apelit e Kosovës – Departamenti për Çështje Administrative me aktgjykimin AA.nr. 72/2016 të datës 28/06/2016 ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ARKEP, ndërsa aktgjykimin e Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, A.nr. 943/2010 i dt. 19/01/2016 e ka vërtetuar.

Bazuar në nenin 68 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative dhe aktgjykimet e lartcekura, Bordi i ARKEP ka bërë rishqyrtimin e çështjes administrative dhe ka konstatuar se:

Operatori IPKO Telecommunications LLC nuk ka zbatuar vendimin Nr. 15 për Përgjime Ligjore të datës 12 prill 2010, me të cilin ARKEP (ish ART) ka aprovuar dokumentin kornizë të strukturuar në formë të marrëveshjes për bashkëpunim mes Policisë së Kosovës dhe operatorëve të rrjetit si dokument obligativ dhe referent për subjektet e marrëveshjes, si dhe ka urdhëruar operatorët e licencuar Telekom i Kosovës Sh.A. (ish PTK Sh.A.) dhe IPKO Telecommunications LLC që të nënshkruajnë marrëveshjet e bashkëpunimit në mes të Policisë së Kosovës dhe operatorëve për Përgjimet Ligjore të Telekomunikacionit.

Me datë 26 gusht 2010 ARKEP ka nxjerr Vendimin nr. 29 për plotësimin e vendimit nr. 15 dhe ka urdhëruar edhe njëherë operatorët e licencuar mobil që të nënshkruajnë marrëveshjen e bashkëpunimit.

Me dt. 27 gusht 2010 ARKEP ka njoftuar IPKO'n dhe palët tjera për datën dhe vendin e nënshkrimit të marrëveshjes kornizë të aprovuar me vendimin nr. 15.

Përderisa, operatori Telekom i Kosovës Sh.A. ka nënshkruar marrëveshjen me Policinë e Kosovës duke e zbatuar vendimin e ARKEP, IPKO Telecommunications LLC nuk ka zbatuar vendimin nr. 15 dhe njëherit ka parashtruar padi pranë gjykatës kompetente për anulimin e e këtij vendimi.

Mirëpo, Gjykata Themelore në Prishtinë – Dep. për Çështje Administrative me aktgjykimin A.nr. 403/10 dt. 14.01.2014 ka refuzuar kërkesëpadinë e IPKO's për anulimin e vendimit nr. 15, si të pa

bazuar. Gjykata ligjshmërinë e aktit administrativ e ka bazuar në nenin 46 par.1 pika c) të Ligjit nr. 2002/7 për Telekomunikacionin (ligj i cila ka qenë në fuqi gjatë nxjerrjes së vendimit), në licencën për telefoni mobile të IPKO's dhe në Kodin e Procedurës Penale.

Ky aktgjykim është vërtetuar edhe me aktgjykimin A.A. nr. 127/2014 dt. 03.02.2015 të Gjykatës së Apelit të Kosovës – Dep. për Çështje Administrative duke e refuzuar ankesën e IPKO's si të pa bazuar.

Duke pas parasysh atë që u tha më lartë është vërtetuar se Vendimi nr. 15 ka qenë i ligjshëm dhe detyrues për operatorët, andaj IPKO ka qenë i obliguar të zbatojë vendimin në fjalë dhe bazuar në nenin 10, paragrafi 7 i Ligjit përcaktohet se Autoriteti: *“Monitoron dhe rregullon dispozitat e komunikimeve elektronike publike të rrjetave dhe shërbimeve.”*

Bazuar në Ligjin nr. 2002/7 për Telekomunikacionin - Ligj i cila ka qenë në fuqi gjatë nxjerrjes së vendimit, në nenin 46 par.1 pika c) është përcaktuar detyrimi i operatorëve të licencuar që të ndërmarrin masa të nevojshme për të siguruar përparimin e zhvillimit të procedurave penale apo për sigurinë së Kosovës. Operatorët duhet të ofrojnë ndërlidhje të përshtatshme në rrjetin e tyre që të mbikëqyrë trafikun e telekomunikacionit në mënyrën, masën dhe kohëzgjatjen e përcaktuar me urdhëresë gjyqi nga autoriteti përkatës.

Po ashtu, bazuar në Licencën nr. 77/07 për ofrimin e rrjetit dhe shërbimeve të telefonisë mobile, neni 19 paragrafi 2, përcakton detyrimet e të licencuarit që të sigurojë masat e arsyeshme në mënyrë që zyrta i autorizuar mund të përgjojë ose regjistrojë bisedat telefonike në përputhje me ligjin e aplikueshëm.

Për shkak të konstatimit të shkeljeve të përsëritura nga ana e IPKO's , sanksioni ekonomik është shqiptuar në përputhje me nenin 101 paragrafi 2 i Ligjit.

Meqenëse, sanksioni ekonomik si i përcaktuar në dispozitivin e këtij vendimi është ekzekutuar nga operatori IPKO Telecommunications LLC, atëherë, ARKEP vetëm e konfirmon sanksionin ekonomik.

Andaj, Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Këshilla Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa por mund të hapet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Prishtine, 30/ 01/ 2018

Autoritetit Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Kreshnik GASHI

Aktvendimi i dërgohet:

- Operatorit IPKO Telecommunications LLC
- Arkivit të ARKEP;